

NDRYSHIMET KLIMATIKE NË DYMBËDHJETË FOTO

Një udhëzues i shkurtër mbi pasojat e ndryshimeve klimatike dhe zgjidhjet e mundshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike





Njerëzit dhe klima – ndikimet



Ndryshimet klimatike të shkaktuara nga njeriu kanë nisur të shfaqen që nga Revolucioni Industrial. Njerëzit luajnë një rol aktiv në këtë proces dhe ndikojnë mbi klimën në të gjitha nivelet e aktivitetit të tyre – që nga shtëpia, trafiku, e deri tek mjedisi i punës.

Pasoja e ndikimit negativ të njerëzimit mbi klimën e Tokës ndjehet përmes ngrohjes globale - sot temperatura mesatare e ajrit në nivel global është 1,10 ° C më e lartë se në fillim të shekullit të 20-të. Në botën tonë ka ndikime të shumta të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike, siç përshkruhet edhe në fotot e mëposhtme.

Ne duhet të kemi gjithmonë parasysh se një ndryshim i tillë kaq drastik i klimës në një periudhë të shkurtër kohore rrezikon mbijetesën e botës së gjallë, duke përfshirë njerëzit dhe cilësinë e jetës sonë.

Një nga mënyrat e mundshme më efektive për të zvogëluar pasojat negative të ndryshimeve klimatike është zbatimi i Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë.

Çfarë janë Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë?

Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) i përkufizon Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) si “veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe resauruar ekosistemet natyrore dhe të modifikuara në mënyra që adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme dhe të përshtatur, për të siguruar mirëqenien e njeriut dhe përfitimet nga biodiversiteti”. ZBN-të çojnë në krijimin e ekosistemeve të shëndetshme dhe funksionale për të ruajtur natyrën dhe në këtë mënyrë për të siguruar mirëqenien e shoqërisë.

Përfitimet prej Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë

- Përqafojnë normat (dhe parimet) për ruajtjen e natyrës;
- Mund të zbatohen vetëm ose në mënyrë të integruar me zgjidhje të tjera për sfidat shoqërore (p.sh. zgjidhjet teknologjike dhe inxhinierike);
- Përcaktohen nga kontekstet natyrore dhe kulturore specifike të vendit që përfshijnë njohuritë tradicionale, vendore dhe shkencore;
- Prodhojnë përfitime shoqërore në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, duke promovuar transparencën dhe pjesëmarrjen e gjerë;
- Ruajnë diversitetin biologjik dhe kulturor dhe aftësinë e ekosistemeve për të evoluuar me kalimin e kohës;
- Zbatohen në shkallë peizazhi;
- Njohin dhe adresojnë kompromiset ndërmjet prodhimit të disa përfitimeve ekonomike të menjëhershme për zhvillim dhe opsioneve të ardhshme për të mundësuar gamën e plotë të shërbimeve të ekosistemit;
- Janë pjesë e pandashme e hartimit të përgjithshëm të politikave dhe masave ose veprimeve për të adresuar një sfidë specifike.

Temperatura e rritur



Pritet që temperatura mesatare vjetore të rritet çdo vit: deri në vitin 2040 temperatura mesatare do të jetë 1,5° C më e lartë.

Kjo mund të duket e parëndësishme, por kjo rritje do të ndryshojë kushtet e jetesës për të gjithë.

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë formojnë hapësira të gjelbra dhe blu në mjediset urbane dhe rurale. Ndërtimi i zonave të reja të gjelbra me lloje të ndryshme bimore dhe pasurimi i atyre ekzistuese do të sigurojë kushte më të mira jetese për njerëzit dhe do të mundësojë zhvillimin e biodiversitetit urban. Ndërtimi i çatave të gjelbra dhe mbjellja e pemëve në qytete mund të zbusë ndikimet e valëve të të nxehtit duke ulur temperaturën mesatare ditore.

ZBN-të kontribuojnë në aftësinë ripërtëritëse të komunitetit, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, zhvillimin socio-ekonomik, krijimin e vendeve të gjelbra të punës, rregullimin e temperaturës së ajrit dhe përmirësimin e shëndetit të njeriut.

Fjalë kyçe: rritje e temperaturës, mjedis rural, mjedis urban, zona të gjelbra

Efekti serë



Efekti serë është pasojë e një çekuilibrimi të energjisë (nxehtësisë) ndërmjet sasisë së nxehtësisë që Toka merr nga Dielli dhe sasisë që ajo çliron sërish në hapësirë.

Ngrohja globale ndodh si rezultat i emetimeve të tepërta të gazeve serë (GS), si dioksidi i karbonit, metani, klorofluorokarburet, oksidet e azotit dhe të tjera që thithin rrezatimin diellor dhe mbajnë nxehtësinë.

Me pak fjalë, efekti serë është ngrohja e pakontrolluar e atmosferës së Tokës.

Djegia e lëndëve djegëse fosile (qymyri, nafta dhe gazi natyror) është burimi më i madh i emetimeve të gazeve serë.

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë përfshijnë restaurimin e ekosistemeve natyrore (pyjet, kullotat, ligatinat dhe habitatet ujore), rritjen e infrastrukturës së gjelbër në qytete dhe mbjelljen e zonave të reja të pasuruara me lloje bimore që ofrojnë kushte më optimale për fotosintezën. Hulumtimet kanë treguar se aplikimi i ZBN-ve mund të zvogëlojë emetimet e gazeve serë me 30%, gjë që është e nevojshme për të stabilizuar ngrohjen globale në më pak se 2°C deri në vitin 2030.

Fjalë kyçe: dioksid karboni, metan, klorofluorokarbon, oksidet e azotit, serë

Flora e ndryshuar

Ndryshimet klimatike, të tilla si thatësitrat dhe rritja e temperaturave mesatare ose ndryshimet ekstreme të temperaturës (rënia dhe ngritja e papritur e temperaturës gjatë një periudhe të shkurtër kohore) mund të shkaktojnë zhdukjen e disa llojeve bimore në zona të caktuara.

Ndryshimet klimatike, në kombinim me faktorë të tjerë, do të çojnë në shfaqjen dhe përhapjen e llojeve bimore aspak karakteristike për zona të caktuara (p.sh. lloje invazive si ambrozia).

Zhdukja e llojeve bimore nga natyra rrezikon furnizimin me lëndë të para për barna, ushqim dhe nevoja të tjera të njeriut, gjë që kërcënon drejtpërdrejt mbijetesën e tij.

Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) krijoi Listën e Kuqe të Llojeve të Kërcënuara™, një listë që përfshin të gjitha llojet bimore të kërcënuara me zhdukje në rang global.

Zgjidhjet e Bazuara në

Natyrë lejojnë rimëkëmbjen e të gjitha llojeve të ekosistemeve natyrore, si pyjet dhe shkurret, kullotat, ligatinat dhe zona të tjera. Këto masa çojnë në rritje të diversitetit biologjik dhe përmirësim të integritetit të ekosistemit.

Fjalë kyçe: lloje bimore, lista e kuqe, restaurimi i habitatit



Fauna e ndryshuar

Ndryshimet klimatike, të tilla si thatësitrat dhe rritja e temperaturave mesatare ose ndryshimet ekstreme të temperaturës (rënie dhe rritje e papritur e temperaturës për një periudhë të shkurtër kohore), çojnë në zvogëlimin e popullatave dhe/ose zhdukjen e llojeve të caktuara të kafshëve.

Zhdukja e disa kafshëve në natyrë ndërpret zinxhirin ushqimor, duke shkaktuar çrregullime të ekosistemit. Për më tepër, zvogëlimi i popullatave ose zhdukja e plotë e llojeve nga natyra zvogëlon diversitetin gjenetik që siguron që kafshët të jenë më rezistente ndaj sëmundjeve dhe të përshtaten më mirë ndaj kushteve të ndryshuara mjedisore.

Prodhimi i kafshëve shtëpiake, dhe me atë ushqim të sigurt për njerëzit, kërkon ekosisteme të shëndetshme natyrore dhe zinxhirë ushqimorë, duke përfshirë brenda edhe faunën e egër.

Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) krijoi Listën e Kuqe të Llojeve të Kërcënuara™, e cila përfshin një pasqyrë të përgjithshme të llojeve të kafshëve të kërcënuara me zhdukje.

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë restaurimi i kullotave, rimëkëmbja e ligatinave, rehabilitimi natyror i pyjeve, masat e drejtpërdrejta për rimëkëmbjen e llojeve të rrezikuara si krijimi i foleve artificiale dhe strehave, etj. Këto masa rrisin si diversitetin biologjik ashtu edhe integritetin e ekosistemit.

Fjalë kyçe: lloje kafshësh, listë e kuqe, zinxhir ushqimor

Terreni i ndryshuar



Zonat e ekspozuara ndaj ndryshimeve të zgjatura ose intensive të kushteve klimatike dhe pasojave të tyre (temperatura jashtëzakonisht të ulëta ose të larta, etj.) mund të degradohen pjesërisht ose plotësisht.

Ndryshimet në terren janë shpesh rezultat i proceseve të erozionit, në një shkallë më të vogël ose më të madhe.

Degradimi i tokës çon në ndryshime në terren, duke i bërë shpesh këto zona të pakapërcyeshme për shkak të zhdukjes së shpateve të buta, krijimit të grykave, zhdukjes së materialit të dyshemesë që lejon lëvizjen e sigurt, grumbullimit të aluvioneve të imëta ose të trasha dhe zëvendësimit të tokës pjellore me material jopjellor. Relievi i ndryshuar gjithashtu ndryshon kushtet e jetesës për llojet bimore dhe shtazore.

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë mbrojtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i zonave pyjore, rimëkëmbja e bimësisë së pyjeve dhe kullotave, rehabilitimi përmes pyllëzimit, masat bioteknike për të zvogëluar ndikimet e erozionit. Këto masa sigurojnë kontrollin e erozionit, furnizimin me ujë dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Fjalët kyçe: proceset e erozionit, degradimi i tokës, kushtet klimatike të ndryshuara

Thatësira



Thatësira është një nga pasojat më të rëndësishme të ndryshimeve klimatike, duke shkaktuar zhdukjen e llojeve të shumta bimore dhe shtazore, si dhe migrimin e njerëzve.

Burimet e ujit të pijshëm dhe puset e krijuara në mënyrë të pavarur thahen më shpesh në verë.

Çrregullimet në cilësinë e ujit janë të zakonshme, pasi nivelet e ulëta ose jashtëzakonisht të larta të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore mund të kontaminojnë ujin e pijshëm, duke e bërë atë të papërshtatshëm për t'u konsumuar.

Çrregullimet në regjimin ujqor të tokës bëjnë që toka të thahet, një nga hapat e parë të shkretëtirëzimit. Si rezultat, toka bëhet e papërshtatshme për kultivimin e të korrave dhe mbijetesën e bimësisë në përgjithësi.

Zgjidhje të Bazuara në Natyrë mbrojtja, restaurimi dhe menaxhimi i habitateve ligatinore, sigurimi i hapësirës për rrjedhën natyrore të lumenjve, rregullimi i shtretërve të lumenjve. ZBN-të siguronë grumbullimin dhe furnizimin me ujë në sasi të mjaftueshme, mbrojtjen nga përmytjet, prodhimin e ushqimit dhe më shumë.

Fjalë kyçe: thatësirë, ujë nëntokësor, ujë sipërfaqësor, ujë i pijshëm

Fatkeqësitë e shpeshta



Mund të priten fatkeqësi më të shpeshta të shkaktuara nga ndryshimi i kushteve klimatike.

Disa nga fatkeqësitë e shkaktuara nga ndryshimet klimatike janë:

Përmytjet – Rritja e sasisë së reshjeve brenda një intervali të shkurtër kohor pritet të jetë një dukuri gjithnjë e më e zakonshme në këtë rajon. Kushtet e tilla klimatike çojnë në përmytje të rrëmbyeshme shkatërruese që mund të dëmtojnë banesat, infrastrukturën ekonomike dhe rrugore dhe tokat bujqësore në afërsi të rrjedhave ujore. Përmytjet në lumenjtë më të mëdhenj janë rezultat i veprimit sinergjik të proceseve natyrore (siç është shkrirja e borës gjatë pranverës), përmytjet e shpejta në rrjedhat më të vogla ujore dhe sasia e madhe e reshjeve. Përmytje të tilla dëmtojnë ndërtesat e banimit, bujqësinë, industrinë dhe infrastrukturën që ndodhen pranë lumenjve më të mëdhenj. Përmytjet në zonat urbane (përmytjet urbane në ujërat e brendshme) shkaktohen nga ndryshimet klimatike, mungesa e fushave natyrore të përmytjes dhe mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për marrjen dhe largimin e ujit

(kullimi i ujërave të stuhisë, rezervuarët e grumbullimit të ujërave të shiut, kanalet kulluese ose të ujërave nga stuhitë, etj.). Përmytjet urbane shkaktojnë dëme në orenditë dhe ambientet e brendshme të shtëpive, por edhe ndërpresin shërbimet publike (arsimin, shëndetësinë, higjienën etj.).

Erozioni dhe rrëshqitjet e dheut. Rritja e shpeshtësisë së thatësirave, përmytjeve dhe zjarreve në pyje çojnë në degradim të tokës, duke rezultuar në erozion dhe rrëshqitje të dheut. Nga ana tjetër, kjo çon në zhdukjen e tokave pjellore, dhe shkatërrimin e infrastrukturës ekzistuese në zonat e prekura nga këto dukuri. Këto fatkeqësi janë të shpeshta në rajonet kodrinore dhe malore dhe shkaktojnë dëme të konsiderueshme në kulturat bujqësore dhe infrastrukturën, ndërsa puna e restaurimit është zakonisht shumë e vështirë, e shtrenjtë dhe shpesh e pamundur. Fatkeqësisht, rrëshqitjet e dheut mund të dëmtojnë ndërtesat e banimit, duke i bërë njerëzit të braktisin vendbanimin e tyre dhe duke detyruar migrimin e popullsisë.

Thatësira. Thatësira shfaqet për shkak të temperaturave ekstreme pa ditë me shi. Kjo lloj fatkeqësie ka pasojat më të

mëdha negative për njerëzit, kafshët dhe bimët. Ndonëse e padukshme teksa ndodh, rezultati i thatësirës shfaqet në peizazhe të ashpra, pa bimësi ose me shumë pak bimësi për të qenë në gjendje të funksionojë në kushte të tilla. Shfaqja e përmbytjeve dhe thatësirave brenda të njëjtit vit do të bëhet gjithnjë e më e zakonshme, duke kontribuar më tej në kushte të vështira jetese.

Zgjidhje të Bazuar në Natyrë

masa për rikuperimin e habitateve në zonat e prekura, masa bioinxhinierike për të zbutur efektet e përmbytjeve (krijimi i digave, gardhimeve, instalimi i rrjetave prej xunkthi, etj.). Përfitimet e këtyre masave përfshijnë forcimin e qëndrueshmërisë së komunitetit, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, kontrollin e erozionit të tokës etj.

Me rëndësi është bashkëpunimi ndërmjet të gjitha palëve të interesuara në nivel vendor, kombëtar dhe rajonal për:

- Të rritur ndërgjegjësimin dhe nivelet e njohurive

midis vendimmarrësve, menaxherëve të burimeve natyrore dhe komuniteteve vendore për Zgjidhjet e Bazuar në Natyrë për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë;

- Të integruar Zgjidhjet e Bazuar në Natyrë në planifikimin dhe politikat e barabarta dhe të përgjegjshme për klimën për përshtatjen dhe zbutjen e fatkeqësive;
- Të zbatuar Zgjidhjet e Bazuar në Natyrë për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe rritjen e mundshme të rrezikut me kalimin e kohës.

Fjalë kyçe: përmbytje, erozion, rrëshqitje dheu, thatësirë, dëmtime, humbje, kushte klimatike të ndryshuara



Migrimi i popullsisë



Ndryshimet klimatike po krijojnë gjithnjë e më shumë kushte të patolerueshme jetese dhe pune, duke rezultuar në migrimin e popullsisë.

Arsyeja më e shpeshtë e migrimit është mungesa e kushteve elementare të jetesës, si uji i pijshëm dhe toka pjellore, por edhe dukuritë negative si rrëshqitjet e dheut.

Thatësira, erozioni, përmbytjet, zjarret e mëdha dhe rrëshqitjet e tokës janë fatkeqësitë më të zakonshme, të cilat në kombinim me shfrytëzimin e tepërt dhe të paqëndrueshëm të burimeve, shkatërrojnë burimet natyrore të nevojshme për jetën.

Deri në vitin 2050, është vlerësuar se 700 milionë deri në 1 miliard njerëz do të detyrohen të ndryshojnë vendbanimin e tyre për shkak të humbjes së tokës së punueshme dhe fatkeqësive që vijnë nga kushtet e ndryshuara klimatike.

Zgjidhje të Bazuara në Natyrë: masat për rikuperimin e habitateve natyrore, menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve agro-pjore, stimuj për popullatën vendase për rritjen e racave të egra të kafshëve dhe kultivimin e varieteteve bimore që përshtaten me kushtet e reja mjedisore. Përfitimet janë burime të mjaftueshme të ushqimit, rregullimi i ujit dhe zhvillimi socio-ekonomik.

Fjalë kyçe: popullsi, shkretëzim, fatkeqësi, ujë, tokë pjellore

Shkrirja e akullnajave



Shkrirja e akullnajave në kapakët polarë të Tokës dhe malet e larta po shkakton një rritje globale të nivelit të deteve.

Me ndryshimet e nivelit të detit ndryshojnë edhe nivelet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke përmbytur zonat bregdetare.

Nëse i gjithë akulli në Groenlandë do të shkrihej plotësisht, niveli i detit do të ngrihej me 7.6 metra.

Sipas disa vlerësimeve, një rritje e nivelit të detit midis 10 dhe 100 centimetra deri në vitin 2100 do të zhyste plotësisht disa ishuj, si Maldivet.

Zgjidhje të Bazuara në Natyrë: ndërhyrjet që sigurojnë rimëkëmbjen e pyjeve, kullotave, ligatinave dhe ekosistemeve ujore, dhe masat që synojnë zbutjen e fatkeqësive si përmbytjet e menjëhershme, zjarret, rrëshqitjet e dheut, etj., do të zvogëlonin pasojat e ndryshimeve klimatike dhe efektin serë, duke kontribuar kështu në stabilizimin e akullnajave në Tokë.

Fjalë kyçe: niveli i detit, shkrirja e akullnajave, përmbytjet

Urbanizimi



Për shkak të kushteve të ndryshuara klimatike, kryesisht rritjes së temperaturës, shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve dhe periudhave të thata, si dhe me presionet në rritje të migrimit njerëzor, do të ndryshojë edhe mjedisi jetësor.

Ndryshimi i kushteve të jetesës do të shkojë gjithnjë e më shumë drejt urbanizimit.

Jini të gatshëm të përshtateni dhe të mësoni të jetoni në një mjedis që funksionon në kushte klimatike të ndryshuara.

Zgjidhje të Bazuara në Natyrë: krijimi i hapësirave të gjelbra dhe blu në zonat urbane, ndërtimi i çativate të gjelbra dhe mbjellja e pemëve në qytete mund të zbusë ndikimin e valëve të të nxehtit duke ulur temperaturën mesatare ditore. ZBN-të gjithashtu kontribuojnë në krijimin e vendeve të gjelbra të punës dhe rregullimin e temperaturës vjetore.

Fjalë kyçe: urbanizim, ndryshim, kushte jetese

Tashmë ka filluar...



Faktorët klimatikë tashmë kanë ndryshuar ndjeshëm ose janë në proces të ndryshimit, veçanërisht temperatura, reshjet dhe lagështia e ajrit.

Pa masa specifike të zbatuara në të gjitha nivelet (në rregullore, planifikim dhe zbatim të aktiviteteve) në përputhje me nevojat e natyrës, sukcesi i njeriut në përshtatjen ndaj kushteve të ndryshuara klimatike është i pasigurt.

Në mënyrë që të gjithë sektorët e shoqërisë (industria, bujqësia, menaxhimi i ujit, pylltaria dhe të tjerë) të përshtaten me ndryshimet klimatike dhe të zhvillohen drejt zvogëlimit dhe përshtatjes ndaj efekteve të tij, kjo temë duhet të trajtohet në rregullore dhe politika sektoriale.

Duhet të planifikohen dhe zbatohen aktivitetet që janë të përshtatshme dhe në përputhje me natyrën. Zbatimi i Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë siguron rimëkëmbjen e

ekosistemeve natyrore dhe funksioneve të tyre, duke ofruar përfitime të shumfishta për njerëzit.

Tema e ndryshimeve klimatike duhet të integrohet në sistemin arsimor në të gjitha nivelet - nga ai parashkollor deri në arsimin e lartë - për të formuar breza që kuptojnë ndryshimet klimatike dhe veprojnë në përputhje me rrethanat.

Një kulturë e veçantë, aktive për sigurinë e çdo individi si edhe për shoqërinë në tërësi është e nevojshme të krijohet.

Fjalë kyçe: ndryshime klimatike, Zgjidhje të Bazuara në Natyrë, rregullore, arsim



Ky material u përgatit si pjesë e projektit ADAPT: Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë për shoqëritë me aftësi ripërtëritëse në Ballkanin Perëndimor. ADAPT është një nismë trevjeçare e financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunimin Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), e zbatuar nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Qëllimi i projektit është të rrisë aftësinë ripërtëritëse të ekosistemeve dhe komuniteteve ndaj ndryshimeve klimatike dhe të zvogëlojë rreziqet nga fatkeqësitë duke zbatuar Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë në Ballkanin Perëndimor.

 @theadaptproject



 Sida

This material/production has been financed by the Swedish International Development Cooperation Agency, Sida. Responsibility for the content rests entirely with the creator. Sida does not necessarily share the expressed views and interpretations.

